



### Kosovë: Deklaratë përmbyllëse e konsultimeve në kuadër të Misionit të Nenit IV për vitin 2026

#### PËR PUBLIKIM TË MENJËHERSHËM

Deklarata përmbyllëse përshkruan gjetjet preliminare të stafit të FMN në fund të vizitës zyrtare apo misionit. Misionet ndërmerren si pjesë e konsultimeve të rregullta në kuadër të [Nenit IV](#) të Statutit të FMN-së. Autoritetet kanë dhënë pëlqimin e tyre për publikimin e kësaj deklarate. Mendimet e shprehura në këtë deklaratë janë të stafit të FMN dhe nuk paraqesin medoemos mendimet e Bordit Ekzekutiv të FMN. Bazuar në gjetjet preliminare të këtij misioni, stafi do të përgatitë një raport i cili, nëse merr aprovimin e menaxhmentit, do të prezantohet para Bordit Ekzekutiv të FMN për diskutim dhe vendimmarrje.

**Prishtinë, Kosovë (13 shkurt)** *Formimi i kuvendit dhe qeverisë së re është mundësi për të rigjallëruar dinamikën e reformave dhe për të përshpejtuar rritjen, duke mbështetur një konvergjencë më të shpejtë me BE-në. Përderisa ekonomia ka treguar qëndrueshmëri karshi ngërçit të zgjatur politik, vlerësohet se rritja është ngadalësuar në vitin 2025, ndërsa inflacioni është përshpejtuar dhe deficiti i llogarisë së jashtme rrjedhëse është zgjeruar. Ngërçi politik ka kufizuar avancimin e zbatimit të agjendës së reformave në kuadër të Planit të Rritjes së BE-së dhe qasjen në financim të jashtëm. Megjithëse perspektiva është pozitive, ende mbesin disa rreziqe negative. Duhet rikalibruar politikën fiskale për vitin 2026 për të ulur impulsin fiskal, dhe për t'i adresuar disbalancat makroekonomikë. Në periudhën afatmesme, politika fiskale duhet të ankorohet në një kornizë të bazuar në rregulla, duke balancuar stabilitetin makroekonomik dhe objektivat zhvillimore, ndërkohë që ndërtohen rezervat fiskale. Sektori financiar është në gjendje të mirë, mirëpo rritja e lartë e kreditimit në vitet e fundit kërkon monitorim të afërt të rreziqeve të sektorit financiar. Duke u bazuar në reformat e kohëve të fundit, duhen përpjekje të mëtejshme për të rritur reziliencën sistematike, së bashku me forcimin e mbikëqyrjes. Reformat strukturore, të bazuara në Planin e Rritjes të BE-së, do të gjenerojnë përfitime për rritjen dhe do të zhbllokojnë mbështetje të konsiderueshme financiare të jashtme në periudhën afatmesme.*

#### **Zhvillimet e fundit**

**Ngërçi i zgjatur politik ka pasur ndikim në rritjen ekonomike të vitit 2025.** Rritja është ngadalësuar në 3½ për qind (vit mbi vit) deri në fund të tremujorit të tretë të

2025, nga 4¼ për qind një vit më parë, pasi konsumi privat dhe investimet u dobësuan karshi ngadalësimit të kreditimit dhe rritjes së të ardhurave reale. Rritja e importit të mallrave, veçanërisht e produkteve në sektorin e energjis, ka çuar në përkeqësim të bilancit tregtar, duke e zgjeruar deficitin e llogarisë së jashtme rrjedhëse në 9.6 për qind të BPV-së, nga 8.4 për qind në vitin 2024. Ky ndikim i jashtëm i rritjes është kompensuar pjesërisht me rritje të konsumit qeveritar dhe investime publike, me mbështetje të përmirësimit të ekzekutimit të buxhetit. Inflacioni u përshpejtua në 5¼ për qind (vit mbi vit) deri në dhjetor, nga 1.1 për qind një vit më parë, i nxitur nga rritja e çmimeve të ushqimeve. Punësimi formal ka vazhduar të shënojë rritje, megjithëse rritja e pagave reale ka stagnuar ndërsa papunësia ka mbetur e lartë (10 për qind). Kjo, së bashku me pjesëmarrjen vazhdimisht të ulët të fuqisë punëtore, veçanërisht atë të grave, është indikacion i kapaciteteve ende të pashfrytëzuara në tregun e punës.

**Këto zhvillime jo aq të favorshme në vitin 2025 erdhën pas një periudhe të rritjes ekonomike mbi nivel të trendeve, dhe të uljes së inflacionit.** Ky progres është mbështetur nga zbatimi i suksesshëm i Marrëveshjes *Stand-By (SBA)* me FMN-në, që ka ndihmuar në frenimin e inflacionit pas pandemisë, mbajtjen e nivelit të rritjes, rindërtimin e rezervave dhe avancimin e reformave kyçe.

### ***Perspektiva dhe rreziqet***

**Me zgjidhjen e ngërçit politik, perspektiva për vitin 2026 pritet të përmirësohet, megjithëse rreziqet mbeten të anuar në kahun negativ.** Rritja parashikohet të rikthehet në 3.8 për qind në vitin 2026 dhe të konvergjojë drejt nivelit të saj potencial prej rreth 4 për qind në afat të mesëm, e mbështetur me rifillimin e reformave strukturore, duke përfshirë zbatimin e Planit të Rritjes të BE-së, si dhe përmirësimin e qasjes në financim të jashtëm. Inflacioni parashikohet të shënojë rënie dhe të konvergjojë drejt 2 për qind në afat të mesëm. Deficiti i llogarisë së jashtme rrjedhëse pritet të rritet në vitin 2026 si pasojë e importeve më të larta të energjisë dhe më pas të ngushtohet gradualisht në periudhën afatmesme. Rreziqet negative për rritjen burojnë nga pasiguria e mundshme politike, tensionet në veri të Kosovës dhe kushtet e pafavorshme të jashtme (p.sh., tensionet në tregtinë globale, përshkallëzimi i konflikteve). Nga ana tjetër, zbatimi i shpejtë dhe efektiv i Planit të Rritjes të BE-së mund ta çojë rritjen ekonomike përtej pritjeve aktuale.

### ***Politika fiskale — Mbështetja e stabilitetit makroekonomik dhe rritjes afatmesme***

**Në vitin 2025 qasja e politikës fiskale ishte ekspansioniste.** Deficiti total është zgjeruar në ¾ për qind të BPV-së nga mesatarja prej ¼ për qind të BPV-së në vitet 2023–24. Deficiti më i ulët është mbështetur nga performanca e fortë e të hyrave, shpenzimet rrjedhëse reale të pandryshuara dhe rritja e shpenzimeve kapitale.

Deficiti më i lartë në vitin 2025, i nxitur nga rritja e transfereve për ekonomitë familjare, ishte më i ulët se parashikimi, si dhe ka ndihmuar në ruajtjen e aktivitetit ekonomik në kushtet e pasigurisë së shtuar politike. Megjithatë, qasja më ekspansioniste, në një kohë kur ekonomia operonte pranë potencialit të saj, mund të ketë nxitur presione inflacioniste dhe zgjerim të disbalancave të jashtme.

**Sipas politikave aktuale, deficiti fiskal pritet të zgjerohet më tej në vitin 2026, duke kërkuar rikalibrim të politikave.** Bazuar në projektbuxhetin e miratuar në tetor 2025 dhe vendimet e fundit ekzekutive, deficiti total parashikohet të rritet në 2 për qind të BPV-së në vitin 2026, duke reflektuar ndikimin vjetor të plotë të rritjes së pensioneve, zgjerimit të shtesave për fëmijë dhe lehona, si dhe masave të reja lidhur me pagat, duke përfshirë futjen e pagës së 13-të për punonjësit publikë. Duhet të shmangët impulsi rezultues fiskal meqë mund të shtojë presionin mbi çmimet vendore, t'i përkeqësojë disbalancat e jashtme dhe t'i zvogëlojë rezervat e Thesarit. Duke pasur parasysh eurozimin, kërkohet një pozicion më i kujdesshëm fiskal, duke synuar deficit prej rreth 1 për qind të BPV-së. Masat e të hyrave dhe shpenzimeve, si ulja e lirimeve tatimore, përafrimi i koeficientëve të pagave në sektorin publik me inflacionin, në vend të ndryshimeve të reja strukturore në politikën e kompensimit, si dhe identifikimi i kursimeve në mallra dhe shërbime, do të ndihmojnë në uljen e impulsit fiskal. Frenimi i rritjes së pagave në sektorin publik jo vetëm që do të mbështeste politika fiskale të kujdesshme, por edhe do të kufizonte efektet zinxhirore në pagat e sektorit privat, të cilat janë duke u rritur më shpejt se produktiviteti, duke ndihmuar kështu në ruajtjen e konkurrueshmërisë. Gjithashtu, disiplina fiskale kërkon respektim të rreptë të kornizës së bazuar në rregulla dhe shmangie të masave të atypëratyshme. Duke pasur parasysh rreziqet e larta negative, prioritet është rindërtimi dhe ruajtja e rezervave adekuate të Thesarit.

**Nga viti 2027 e tutje politika fiskale duhet të balancojë stabilitetin makroekonomik dhe objektivat zhvillimore, të përmirësojë strukturën e shpenzimeve dhe t'i prioritzojë reformat strukturore fiskale kyçe.** Politika fiskale duhet ta mbështesë rritjen përmes lehtësimit të rritjes së investimeve publike cilësore, të financuara përmes Planit të Rritjes së BE-së dhe nga partnerë të tjerë ndërkombëtarë. Frenimi i shpenzimeve rrjedhëse dhe forcimi i menaxhimit të financave publike janë të nevojshme për të shmangur rritjen e shpejtë të borxhit, për të mbështetur pozicionin e jashtëm dhe për të ruajtur rezerva të mjaftueshme. Duhet të vazhdojë progresi në administrimin e të hyrave, përmirësimin e efikasitetit dhe barazisë së shpenzimeve sociale, rritjen e efektivitetit të shpenzimeve në shëndetësi dhe arsim, forcimin e menaxhimit të investimeve publike dhe rreziqeve fiskale, si dhe rritjen e transparencës fiskale

**Përditësimi i kornizës fiskale të Kosovës do ta përfronte më mirë politikën fiskale me prioritetet e ndryshueshme, duke forcuar njëkohësisht**

**transparencën dhe besueshmërinë.** E miratuar më shumë se një dekadë më parë, korniza aktuale i ka shërbyer mirë Kosovës, duke mbështetur stabilitetin makroekonomik dhe menaxhimin e kujdesshëm fiskal. Reformat e planifikuara ofrojnë mundësi për modernizimin e kornizës ligjore, duke krijuar hapësirë për investime publike që nxisin rritjen, ndërkohë që kufizojnë diskrecionin dhe forcojnë transparencën dhe përbushjen. Në këtë kontekst, rregulli për deficitin duhet të thjeshtohet duke hequr mekanizmat korigjues dhe përafuar atë me Paktin e Stabilitetit dhe Rritjes të BE-së, duke ruajtur njëkohësisht kufirin aktual të borxhit. Krijimi i një këshilli fiskal të pavarur do të rriste edhe më shumë llogaridhënien përmes monitorimit më të afërt të përbushjes dhe vlerësimit të cilësisë së politikës fiskale.

### ***Politikat financiare — Forcimi i mbikëqyrjes dhe gatishmërisë për kriza***

**Rritja e lartë e kreditimit kërkon forcim të mbikëqyrjes prudenciale.** Thellimi financiar i drejtuar nga bankat ka qenë i konsiderueshëm, me raportin e kredive sipas BPV-së që pothuajse është dyfishuar gjatë dekadës së fundit duke arritur në 60 për qind në vitin 2025 — ndër nivelet më të larta në vendet evropiane në zhvillim. Përkundër këtij zgjerimi të bilancit të gjendjes, sektori bankar mbetet i qëndrueshëm, me profitabilitet solid, nivel të ulët të kredive joperformuese dhe rezerva të mjaftueshme likuiditeti. Megjithatë, ritmi i zgjerimit të kreditimit kërkon monitorim të afërt, veçanërisht duke pasur parasysh lehtësimin e standardeve të huadhënies dhe ekspozimin e bankave ndaj sektorit të pasurive të paluajtshme. Nëse përshpejtohet përsëri rritja kreditore, duhet të merren në konsideratë masa të targetuara makroprudenciale të bazuara te huamarrësit për të mbrojtur kapacitetin e shlyerjes së borxhit të huamarrësve, duke plotësuar zbatimin e rezervave kundërciklike të kapitalit në vitin 2025. Rifillimi i aktivitetit legjislativ paraqet mundësi për avancimin e ndryshim-plotësimeve në Ligjin për Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) në përputhje me rekomandimet e FMN-së.

### **BQK duhet ta vazhdojë progresin e arritur në forcimin e mbikëqyrjes financiare.**

Një sektor financiar më i madh dhe më kompleks kërkon forcim të mëtejshëm të kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës. Me mbështetjen e FMN-së, BQK është duke përmirësuar mbikëqyrjen e bazuar në rrezik, përfshirë zbatimin gradual të një Procesi modern të Rishikimit dhe Vlerësimit Mbikëqyrës (SREP), me synim rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes dhe reziliencës së bankave. Zbatimi i suksesshëm do të kërkojë të dhëna më të mira mbikëqyrëse, kapacitete teknike më të forta, staf të aftësuar, si dhe përshtatje të kulturës dhe praktikave mbikëqyrëse. Nevojiten edhe masa për të përforcuar mbikëqyrjen e institucioneve financiare jobankare (përfshirë ndryshimet ligjore dhe aktivitetet me kripto-asete), për të ruajtur integritetin financiar, për t'i mbrojtur konsumatorët dhe për t'u përafuar me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

**Reziqet e shtuara nënvizojnë rëndësinë e forcimit të reziliencës sistemike dhe gatishmërisë për menaxhimin e krizave.** Ndonëse sektori bankar ka dëshmuar kapacitet të fortë për absorbimin e tronditjeve sistemike të likuiditetit, kjo do të varet në masë të madhe nga mirëmbajtja e vazhduar e rezervave adekuate dhe cilësore të likuiditetit, rezervat e mjaftueshme ndërkombëtare, si dhe gatishmëria operacionale për reaguari ndaj streseve. Prioritetet e politikave duhet të përfshijnë vazhdimin e akumulimit të rezervave, mbrojtjen e asetëve likuide të bankave dhe zhvillimin, operacionalizimin dhe testimin e mëtejshëm të kornizës së menaxhimit të krizave, me mbështetje të FMN-së dhe përshtatje sipas nevojës. Duke pasur parasysh euroizimin, qasja e vazhdueshme në likuiditetin e Bankës Qendrore Evropiane (BQE) përmes një linje të riblerjeve (repo) do të mbështeste kapacitetin e sistemit për ta përballuar stresin. Pas miratimit të Ligjit për Bankat, përpjekjet tani duhet të fokusohen në operacionalizimin e kornizës se si duhet vepruar për mbylljen e bankave.

**Nevojiten përpjekje të përbashkëta për të mbështetur përpjekjet e BQK-së për integrimin e Kosovës në Zonën e Vetme të Pagesave në Euro (SEPA).**

Anëtarësimi në SEPA do t'i standardizonte pagesat ndërkufitare me 41 juridiksionet pjesëmarrëse, duke i bërë transaksionet më të shpejta, më të sigurta dhe më efikase, ndërsa do të lehtësonte integrimin më të thellë financiar me Evropën. Pas para-aplikimit në vitin 2024, anëtarësimi i suksesshëm do të varet nga miratimi në kohë i kornizës së kërkuar ligjore, duke theksuar nevojën për koordinim të ngushtë ndërmjet të gjitha palëve të interesit në Kosovë. Paralelisht, zbatimi i duhur i projektit për vendosjen e një platforme të ngjashme me TIPS do të modernizonte më tej infrastrukturën vendore të pagesave.

### ***Reformat strukturore — Adresimi i sfidave të thella***

**Normalizimi politik duhet të shfrytëzohet për ta avancuar progresin drejt anëtarësimin në BE.** Megjithëse Kosova ishte ndër vendet që shumë herët kishin miratuar Agjendën e Reformave të Planit të Rritjes së BE-së, zbatimi në vitin 2025 ishte i kufizuar nga mungesa e legjislativit. Rifillimi i procesit legjislativ do të ofrojë mundësi për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe përshtetimin e reformave, duke ndihmuar në ngushtimin e hendeqeve strukturore me BE-në dhe në gjenerimin e përfitimeve për rritjen. Gjithashtu, zbatimi i plotë dhe në kohë i Agjendës së Reformave do t'i mundësojë Kosovës që të përfitojë financim nga BE-ja në vlerë prej 8 për qind të BPV-së, alokimi më i lartë në Ballkanin Perëndimor.

**Reforma gjithëpërfshirëse e tregut të punës do të ndihmojë në heqjen e kufizimeve ndaj rritjes.** Politika e pagës minimale duhet të balancojë produktivitetin dhe kostot e jetesës për të ruajtur aftësinë konkurruese, veçanërisht duke pasur parasysh euroizimin. Me një nga normat më të ulëta të pjesëmarrjes të fuqisë punëtore në Evropë, veçanërisht ndër gratë, dhe me papunësi vazhdimisht të lartë, reformat duhet të prioritojnë adresimin e mospërputhjes së shkathtësive, uljen e

informalitetit, zgjerimin e qasjes në kujdes të përbalueshëm për fëmijë dhe avancimin e pushimit prindëror.

**Duhet të rigjallërohen reformat në energji për t'i zgjeruar kapacitetet e prodhimit, duke përfshirë ato nga burimet e ripërtëritshme, për të përmirësuar eficiencën dhe për t'i përafruar më mirë çmimet me kushtet e tregut.** Përsheptimi i zbatimit të projekteve të energjisë së ripërtëritshme do të shtojë kapacitete në miksin e prodhimit të energjise në periudhën afatmesme, duke ndihmuar në përmbushjen e kërkesës në rritje dhe duke ulur varësinë nga qymyri. Është jetike të vazhdojnë investimet në kapacitetet prodhuese për të siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe për të rritur aftësinë konkurruese; masat për përmirësimin e eficiencës energjetike do t'i ndihmojnë familjet dhe bizneset që t'i ulin kostot. Liberalizimi i tregut të energjisë elektrike duhet të avancojë ashtu që të nxisë konkurrencën, t'i tërheqë investimet private dhe të forcojë likuiditetin sektorial, duke minimizuar njëkohësisht ndërprerjet dhe barrën financiare për konsumatorët.

**Duke u mbështetur në një partneritet të fortë dhe afatgjatë, FMN-ja do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën në ruajtjen e stabilitetit makro-financiar dhe avancimin e reformave kyçe.** Që nga anëtarësimi në FMN në vitin 2009, Kosova ka përfituar nga programet e mbështetura nga FMN-ja, mbikëqyrja dhe zhvillimi i kapaciteteve. Marrëveshjet më të fundit me FMN-në — Marrëveshja Stand-By (SBA) dhe Instrumenti për Reziliencë dhe Qëndrueshmëri (RSF) — janë përmbyllur në maj 2025. SBA dhe RSF kanë mbështetur përpjekjet për të frenuar inflacionin, për të ruajtur rritjen e fortë, për rindërtimin e rezervave politikave, si dhe avancimin e reformave strukturore, duke përfshirë tranzicionin e gjelbër. FMN do të vazhdojë të ofrojë këshilla për politika dhe të ruajë mbështetjen për zhvillimin e kapaciteteve, përfshirë përmes Qendrës Rajonale të Asistencës Teknike për Evropën Juglindore (SEETAC), e cila pritet të themelohet së shpejti.

\* \* \* \* \*

*Misioni ynë shpreh falënderime për autoritetet e Kosovës dhe palët e tjera për mikpritjen dhe diskutimet e sinqerta dhe konstruktive.*

## Kosovë: Tregues të përzgjedhur ekonomikë 2024–31

	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031
	Act.	Prel.	Proj.	Proj.	Proj.	Proj.	Proj.	Proj.
<b>Produkti (Outputi)</b>								
Rritja reale e BPV-së (përqindje)	4.6	3.4	3.8	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0
<b>Punësimi</b>								
Shkalla e papunësisë (përqindje)	10.8	...	...	...	...	...	...	...
<b>Çmimet</b>								
Çmimet e konsumit (mesatarja e periudhës)	1.6	3.9	3.1	2.2	2.0	2.0	2.0	2.0
Çmimet e konsumit (eop, përqindje)	1.1	5.3	2.0	2.0	2.0	2.0	2.0	2.0
Deflatori i BPV-së (përqindje)	2.2	2.9	3.8	2.3	1.8	1.9	2.0	2.0
<b>Financat e Përgjithshme të Qeverisë (përqindje e BPV-së)</b>								
Të hyrat dhe grantet	29.9	30.4	30.4	30.4	30.4	30.5	30.5	30.5
Shpenzimet	30.2	31.2	32.4	32.4	32.4	32.5	32.5	32.5
Bilanci i përgjithshëm	-0.3	-0.8	-2.0	-2.0	-2.0	-2.0	-2.0	-2.0
Borxhi publik total	17.9	17.6	19.0	20.4	21.9	23.1	24.2	25.0
Stoku i bilancit bankar të qeverisë	3.8	3.8	3.6	3.8	4.0	4.2	4.3	4.5
<b>Parat dhe Kreditë</b>								
Kredit Joperformuese (perq. e total kredit)	1.8	...	...	...	...	...	...	...
Kredit për sektorin privat (ndryshimi ne perq.)	18.3	14.6	12.3	11.0	9.9	9.1	8.8	8.5
Norma efektive e kreditimit (përqindje)	5.9	...	...	...	...	...	...	...
<b>Bilanci i pagesave (përqindje e BPV-së)</b>								
Bilanci i llogaris rrjedhëse	-8.4	-9.6	-10.0	-9.8	-8.9	-8.2	-8.0	-7.7
Të hyrat nga remitencat	13.1	12.9	12.7	12.7	12.8	12.8	12.8	12.9
Investimet e huaja direkte	5.5	5.8	6.2	6.5	6.7	7.0	7.2	7.4
Borxhi i jashtëm	40.7	46.2	51.3	57.1	60.7	63.7	67.1	68.9

Burimet: Vlerësimet e autoriteteve të Kosovës dhe të stafit të FMN-së.

